

## Akti i Themelimit

BelTours Travel Agency

Tiranë-Shqipëri

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)

Sot, me datë 06. 03. 2024, të nënshkruarit:

**Znj. Brunilda Kozma Paskali**, e bija e Kozmait dhe e Viollandës, lindur në Korçë , me adresë banimi Njësia Administrative Nr.7, Rruga: Blv.Gjergj Fishta, Nd. 22, H. 16, Ap.17 ,Tiranë, me kombësi shqiptare, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër G55905142Q

**Znj. Albana Selim Veizi**, e bija e Selimit dhe e Shpresës, lindur në datë 31.03.1981 në Kavajë, me adresë banimi Njësia Administrative Dajt, Rruga "Muhamet Deliu" (rruga e Teleferikut), Pallati AKR Construction, 1040, Tiranë, me kombësi shqiptare, mbajtëse e kartës së identitetit me numër personal I15331158Q.

Me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (Ligji i Shoqërive) kanë vendosur të krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **BelTours Travel Agency** ("Shoqëria") duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

### Neni 1. Emri dhe forma ligjore

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë **BelTours Travel Agency** ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "sh.p.k.", i cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2 Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(Ligji i Shoqërive).

### Neni 2. Selia dhe kohëzgjatja

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Mihal Grameno", Pallati Vjero, kati II, 1001, Tiranë. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

- 2.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

### **Neni 3. Objekti i veprimtarisë**

#### **3.1 Shoqëria ka për objekt:**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e turizmit, hotelierisë, udhëtimeve turistike dhe transportit të udhëtarëve; Organizim udhëtimesh turistike, brenda dhe jashtë vendit; Shitje biletash avioni, autobusi dhe trageti; Shitje biletash online; Shitje dhe blerje paketash turistike; Organizim eventesh; Bashkëpunim me shoqëri të tjera turistike, shoqëri udhëtimi, shoqëri transportesh vendase dhe të huaja, hotele, restorante, etj.; Shitje e produkteve dhe shërbimeve të agjencisë; Aplikim për viza; Agjent sigurimesh; Dhënie makinash me qera; Ushtrim veprimtarie në real estate (shitje, blerje, dhënie me qera pronash të paluajtshme).

### **Neni 4. Kapitali fillestar dhe ndarja e tij**

- 4.1 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 100 000 (njëqind mijë) lekë, ku pjesëmarrja e secilit Ortak të Shoqërisë në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

Znj. Brunilda Kozma Paskali, zotëron një kuotë të barabartë me 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, ekuivalente me 70 000 (shtatëdhjetë mijë) Lekë vlerë nominale.


Znj. Albana Selimi Veizi, zotëron një kuotë të barabartë me 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, ekuivalente me 30.000 ( tridhjetëmijë) Lekë vlerë nominale.

### **Neni 5. Organet drejtuese dhe Administrimi**

- 5.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

- 5.2 Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.
- 5.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë:

| Të dhënat e identifikimit  | Specimeni i nënshkrimit  |
|--|--|
| Znj. Brunilda Kozma Paskali, e bija e Kozmait dhe e Viollandës, lindur në Korçë, me adresë banimi <b>Njësia Administrative Nr. 7, Rruga: Blv.Gjergj Fishta, Nd. 22, H. 16, Ap. 17, Tiranë</b> , me kombësi shqiptare, mbajtës i katrës së identitetit me numër <b>G55905142Q</b> . |  |

**Neni 6. Të tjera**

- 6.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, Ligjit për Shoqëritë dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
- 6.2 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërisë, sot më datë 06. 03. 2024 në gjuhën shqipe, në katër kopje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQERISË**

Znj. Brunilda Paskali



Znj. Albana Veizi

